

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“AURORA BEAUTY” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më date 26.03.2021 une, i nenshkruari:

1. **Luca D'Ambrosio**, shtetas italian, lindur ne Itali, i datëlindjes 20.07.1982, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane AY 9611337
2. **Laura Mason** , shtetase italiane, lindur ne Itali, e datëlindjes 24.12.1980, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti italiane AX 6617063
3. **Anila Çupi**, shtetase shqiptare, lindur ne Guri i Bardhe, e datëlindjes 14.06.1988, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi karte identiteti I85614076E

themeloj një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin:

“AURORA BEAUTY” SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj, me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Arapaj, Rruga Ullishtja, Zona Kadastrale 1031, Godine me nr. Pasurie 270/19, Durrës.

Shoqëria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashtë vendit.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë e saj si vijon:

Tregtim të produkteve kozmetikes dhe bukurise, parfumeve, make up, kremra të ndryshem, produkteve estetike, detergjente të ndryshem, produkteve të pastrimit, madje edhe në nivel industrial, bizhuteri, etj.

Tregtim artikuj të ndryshem konfeksione, veshje të ndryshme për burra gra dhe femije.

Shitje në internet, tregti elektronike on-line, tregtim me shumice e pakice në dyqanesh dhe në dyqan ambulant të tilla si karavanet, në Shqipëri dhe jashtë vendit.

Sherbime pastrimit për individ dhe kompani, përfshirë dezinfektimin të mjediseve.(COVID-19)

Për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mund të kryejë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e objektit të shoqërisë, midis të tjerash të blejë interesa, aksione, pjesëmarrje të kapitalit, në shoqëri të tjera, konsorciume ose kompani të cilat kanë objekte të ngjashme apo analoge me të vetin dhe të kryejë të gjitha veprimet komerciale, industriale, financiare. Në vecanti, shoqëria, mund të marrë në pronësi, uzufukt ose qera, kompani ose dege kompanish që operojnë në fushën e një ose me shumë prej veprimtarive të mesiperme.

Gjithmone, për të vetmin qëllim të arritjes së objektit të lartpërmendur, shoqëria mundet gjithashtu të japë garanci, garanci

mbi kreditë dhe depozitat, le lere peng te mira dhe vlere te tundshme, te vendose garanci hipotekore mbi te mirat e patundshme dhe te tundshme te regjistruara, dhe te vendose ne pergjithesi cdo garanci te mundshme reale dhe personale.

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është 10.000(dhjetemije) lekë, i ndarë në 3 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Luca D'Ambrosio është zotërues i 1 kuote, me 60 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 6.000 leke.

Laura Mason është zotërues i 1 kuote, me 20 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 2.000 leke.

Anila Çupi është zotërues i 1 kuote, me 20 % pjesmarrje në kapitalin e shoqërisë me vlere 2.000 leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

- (-) Asambleja e Përgjithshme.
- (-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Anila Çupi** për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.


Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.
Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet
legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKB-në si dhe çdo ligj tjetër
mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakeve të Shoqerisë

Luca DiAmbrosio

Laura Mason

Handwritten signatures of Luca DiAmbrosio and Laura Mason. The signature of Luca DiAmbrosio is on the left, and the signature of Laura Mason is on the right, both written in black ink.

Anila Çupi

Handwritten signature of Anila Çupi, written in black ink.